

VENDIM
Nr. 618, datë 29.7.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 20.10.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, UNAZA E MADHE E
TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 718, datë 20.10.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 3, 4 dhe 5, ndryshohen si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 16 978 (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) m², me vlerë 44 519 117.37 (dyzet e katër milionë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë, për objekte, me vlerë 24 323 494 (njëzet e katër milionë e treqind e njëzet e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë dhe kultura drufrutore me vlerë 382 400 (treqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 69 225 011.37 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e njëzet e pesë mijë e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen:

- nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë;
- nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 69 225 011.37 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e njëzet e pesë mijë e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë, të përballohet:

- nga buxheti i vitit 2011 zëri “investime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, vlera 68 842 611.37 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë;
- nga fondet buxhetore për vitin 2020, të miratuar në zërin “Shpronësime”, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, në programin buxhetor “Transporti rrugor”, vlera 382 400 (treqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë.”

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lista e pronarit që shpronësohet

Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 718, datë 20.10.2011, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Unaza e Madhe e Tiranës"

Vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.8.2000, i ndryshuar
Udhëzimit nr. 1, datë 05.10.2000, "Për kriteret teknike të përlogaritjes së vlerës së drufrutorëve"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Vlera e kulturave bujqësore dhe drufrutorëve (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime
1	Shyqyri		Brahja	3266	84/7	382,400	382,400	Sipas procesverbalit
SHUMA TOTALE						382,400	382,400	